



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE INTEGRIMIT DHE ASETIVE  
SEKTORI I ASETIVE

Projekt – Vendim

Nr 20 Datë 21.11. 2023

Rishqyrtim i vendimit nr 38, datë 28.04. 2023, të Këshillit Bashkiak “Dhënie pëlqimi në parim, për dhënie në përdorim me anë të konkurimit, të sipërfaqes prej 31.03 Ha, pjesë të pasurive nr 736 dhe 738, Zk nr 3769, e llojit “Livadh”, (Kullotë), në fshatin Vig, Nj Ad Vig Mnelë, Bashkia Vau Dejës.

Fusha e përdorimit të pronës: “Për ndërtim parku fotovoltaik, aerogjeneratorë (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj)

Në mbështetje të Ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1” (ndryshuar), neni 55 pika 3, neni 27 pika 5, ligji nr 38/2019, ligji nr 8743, datë 22.01.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligji nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 10, datë 07.01.2005, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në komunën Vig Mnelë të Qarkut të Shkodrës”, VKM nr 559, datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore.”, Udhëzimin nr 1, datë 09.06.2016 të Ministrisë së Mjedisit “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, çertifikatën e pronësisë për pasurinë nr 736, me Kod Unik 3769003235, kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe fragment harte kadastrale për pasurinë nr 738, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të:

**VENDOSI :**

1. Miratimin në parim të dhënies në përdorim me anë të konkurimit, me afat 10 vjet, të sipërfaqes prej 31.03 Ha, e llojit “Livadh” (Kullotë), pjesë të pasurive nr 736 dhe 738, Zk nr 3769, fshati Vig, NJAD Vig Mnelë, Bashkia Vau Dejës, duke plotësuar dokumentacionin me çertifikatën e pronësisë **për pasurinë nr 736**, dhe kartelën e pasurisë, fragment harte kadastrale, në pritje për të marrë çertifikatën e pronësisë për **pasurinë nr 738**, pas aplikimit të kryer pranë ZVRPP me nr 16022, datë 07.09.2023.
2. Efektet: Jep impakt pozitiv në komunitet duke hapur vende të reja pune, si dhe sigurohen të ardhura për Bashkinë, që kthehen më pas në investime publike.

3. Vlera dysheme e qirasë vjetore, të jetë sipas pikës 8/4, shtojca nr 1, të VKM-së Nr 559, datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”.
4. Pas miratimit në Këshillin Bashkiak, dhe shprehjes së ligjshmërisë nga ana e prefektit të Qarkut Shkodër, do bëhet shpallja në Buletinin e Njoftimeve Publike, dhe vazhdimi i procedurës së konkurimit publik me të gjithë elementët e saj përbërës deri në lidhjen e kontratës së qirasë me subjektin fitues.

**HARTUESIT E PROJEKT VENDIMIT**  
**DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE INTEGRIMIT DHE ASETËVE**

Konceptoi: Sp/sek Aseteve Denada Dodaj

Miratoi: P/sek Aseteve Ndoc Baqli

Konfirmoi bazën ligjore:

Spektori Ligjor;

Juriste

Stefani Jaku

Pranoi: Drejtori Bib Miria

**KRYETARI**

**Kristian Shkreli**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS  
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE INTEGRIMIT DHE ASETVEVE  
SEKTORI ASETVEVE

RELACION  
MBI

**Rishqyrtimin e vendimit nr 38, datë 28.04.2023, “Dhënie pëlqimi në parim për dhënie në përdorim me anë të konkurimit të pasurisë shtetërore të llojit “Livadh” (Kullotë), “Për ndërtim parku fotovoltaiq”, aerogjeneratorë (bazamentet, objektet përkatëse etj).**

**Këshillit Bashkiak Vau i Dejës**

**Të nderuar këshilltarë,**

Administrimi i fondit pyjor dhe kullor në territorin e Bashkisë Vau i Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin nr 27 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ku në piken 5 të këtij neni përcaktohet: Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik, sipas legjislacionit në fuqi.*

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit Pyjor/ Kullor është ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9 pika 1.2 c, neni 54 pika e/I, neni 18, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë, miratimi i dhënies në përdorim të tretëve të pasurive në pronësi apo administrim të Bashkisë.

Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”. Sipërfaqja e marrë në studim që propozojmë të jepet në përdorim, është e llojit “Livadh” (Kullotë), që shtrihet në dy pasuri, përkatësisht me nr 736 dhe 738 në Zk nr 3769, ku pasuria nr 736, është e paisur me **çertifikatë pronësie, lloji “Livadh” (Kullotë)**, ndërsa për pasurinë me nr 738 kemi nxjerrë kartelën e pasurisë dhe fragment harte kadastrale ku pasqyrohet lloji kadastral “**Livadh**” Gjithashtu kemi aplikuar me datë 07.09 2023 për lëshim çertifikatë pronësie për pasurinë nr 738, dhe jemi në pritje të daljes saj.

Kjo sipërfaqe do jepet në përdorim, për ndërtim parku fotovoltaiq, aerogjeneratorë, (bazamentet, dhe objektet përkatëse etj), duke ndjekur procedurat e konkurimit publik me të gjithë elementet e saj përbërës, sipas legjislacionit në fuqi për dhënien në përdorim të pronës shtetërore. Rishikimi i

këtë projekt vendimi bëhet për arsye plotësim dokumentacioni me çertifikatë pronësie, saktësim i llojit të pasurisë, ku sipas çertifikatës së pronësisë dhe kartelës së pasurisë është lloji "Livadh".

Sipërfaqja e përgjithshme që shqyrtohet për tu dhënë në përdorim është 31.03 ha. Kjo sipërfaqe shtrihet në dy pasuri, përkatësisht, sipërfaqja prej 3.3 Ha, është pjesë e pasurisë nr 736, dhe sipërfaqja prej 27.73 Ha, është pjesë e pasurisë nr 738, të dyja pasuritë ndodhen në Zk nr 3769, në fshatin Vig, NjAD Vig Mnelë, Bashkia Vau Dejës.

Në funksion të sipërfaqes që merret në përdorim, sipas VKM-së nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor/kullosor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore", Shtojca 1, pika 8/4, si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit si më poshtë.


8. Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linje të tensionit, aerogeneratorë dhe fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj.).				
Nr.	Përdorimi i territorit	Sipërfaqja e përdorur në Ha	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/Ha/vit	
			1 vit	2- 5 vjet 6-10 vjet
1	Kullote	192.000	183.000	176.000

Sipas tabelës më sipër, rezulton se sipërfaqja prej 31.03 ha x 176 000 lek = 5 461 280 (Pesë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e një mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë /vit.


Duke ju falenderuar, ju ftojme të miratoni këtë projekt vendim.

#### Grupi i punës

Ing. Mark Suli



Ndoc Baqli



Ilda Prendi



KRYETARI

Kristian Shkreli



## RAPORT

**MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM TË SIPËRFAQEVE KULLOSORE NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË VAU DEJËS "PËR PARK FOTOVOLTAIK", AEROGJENERATORË (OBJEKTET, PËRKATËSE ETJ).**

Bazuar në Urdhërin **nr.20, datë 26.01.2023** të Kryetarit të Bashkisë, për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore e kullosore për dhënie me qira "Grupi i punës i përbërë nga z.Ndoc Baqli Përgjegjës i sektorit të aseteve, z. Mark Suli, specialist i administrimit të pyjeve dhe kullotave ,z.Ilda Prendi, specialiste, nga data **06.11.2023** deri në datën **10.11.2023**, realizoi verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqes, objekt dhënie në përdorim me sipërfaqe **31.03 ha "Për park fotovoltaik", (aerogjeneratore, stacionet, objektet përkatëse etj).**

Mbështetur në të dhënat e inventarit të pronave të Bashkisë Vau Dejës, përkatësisht VKM nr 10, datë 07.01.2005, "Për miratimin e listës së pronave të paluajtshme publike të shtetit në komunën Vig Mnelë, të qarkut të Shkodrës", në çertifikatën e pronësisë me kod unik 3769003235, si dhe në shkresën nr 710 prot, datë 10.01.2023, ardhur nga ASHK, Drejtoria Vendore Shkodër, ku pasqyrohen kartelat dhe fragmenti i hartës kadastrale, për pasuritë që kërkojmë të marrim në shqyrtim, rezulton se sipërfaqja që kërkohet të merret në përdorim është **31.03 ha** ha për **"Për park fotovoltaik", (aerogjeneratore, stacionet, objektet përkatëse etj),** të shtrira në pasuritë **nr.736 me sipërfaqe 3.3 ha, dhe në pasurinë nr 738 me sipërfaqe 27.73 ha, ndodhur në Zk nr 3769** të fshatit Vig, Nj Administrative Vig Mnelë, në pronësi/administrim të Bashkisë Vau Dejës.

Përshkrimi parcelar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj pasqyrohen në tabelat 1 dhe 2 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje: *(sipas tabelave përkatëse Bashkëlidhur).*

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacion jepen në përdorim për një afat **10 vjet, me një sipërfaqe prej 31.03 ha "për park fotovoltaik", (aerogjeneratore, objektet përkatëse etj).**

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor publik janë të mbështetura në V.K.M-në nr. 888, datë 27.12.2022, "Për rastet e dhënies në përdorim ,dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimi në volum nga fondi pyjor kombëtare apo zgjerimin e tyre.", në VKM-ve nr 1374, date 10.10.2008, të ndryshuar "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor". Udhëzimin e Ministrisë së Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" pika nr 2 germa (a) dhe pika 7.

*Sipërfaqja e marrë në studim do të nënshtrohet procedurës sipas legjislacionit në fuqi.*

Pas miratimit të raportit tekniko - ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër, kryetari Bashkisë nxjerr urdhërin për përgatitjen e dokumentave të ankandit nëpërmjet procedurës së konkurimit publik.

Tarifat e dhënies në përdorim nga fondi pyjor kullor bazohen në VKM-venë nr. **nr.559, datë 29.07.2022** "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore" shtojca nr 1 pika 8/4 si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit.

**Shuma në lek/vit konsiston në:**

**1. Vlerën përdorimit lekë për /ha/vit“, Për park fotovoltaik”, (aerogjeneratorët, stacionet, objektet përkatëse, bazamentet etj).**

a) Pasuria nr.736 ,sipërfaqe prej 3.3 ha x 176 000 leke = **580.800** lekë/ vit

b) Pasuria nr.738 ,sipërfaqe prej 27.73 ha x 176 000 leke = **4,880,480** lekë ne vit

**Në total nga mbledhja e vlerave të mësipërme del shuma 5,461,280 (Pesë milion e katërqind e gjashtë dhjetë e një mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë/vit.**

#### **PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK**

**Ndoc Baqli**



**Mark Suli**



**Ilda Prendi**



**KRYETARI**

**Kristian Shkreli**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

# ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI PRONËSIE

PRONARI/BASHKËPRONARËT		
Emri i Personit Juridik	Nr. Personal NIPT	Pjesa(-/-)
BASHKIA VAU - DEJES	K56705007O	1/1

Numri i Pasurisë	736		
Kodi Unik	3769003235		
Zona Kadastrale	3769		
Lloji i Pasurisë	LIVADH		
Sipërfaqja e pasurisë (m2)	Totali: 48663	Truall: 0	Ndërtesë: 0
Vlera Aktuale e Pasurisë	1		
Adresa e Pasurisë	SHKODER, VAU-DEJES/VIG-MNEL, Rr.: -		

DREJTORI  
Deart Qori

Erion  
Rrushi

Digitally signed by:  
Erion Rrushi  
Date: 2023.09.13  
11:35:05 +02'00'

Anila  
Hoxha

Digitally signed by:  
Anila Hoxha  
Date: 2023.10.17  
03:39:54 +02'00'

Deart  
Qori

Digitally signed by:  
Deart Qori  
Date: 2023.10.17  
04:01:06 +02'00'



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria  
Vendore Shkodër  
Date: 2023/09/13 11:34:20 +02'00'  
K56705007O2023091311341308L1014



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 3769003235  
(Nga \_\_\_\_\_, Në \_\_\_\_\_)

**A - TË DHËNAT E PASURISË**

Zona Kadastrale Nr. 3769 , Lloji i Pasurisë: LIVADH , Nr. i Pasurisë: 736 , Sipërfaqja Totale 48663  
m2, (Nga të Cilat Truall 0 m2; Ndërtesë 0 m2)

Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-76(57-C) , Numri i Pemëve: 0 ,  
Adresa e Pasurisë: Bashkia VAU-DEJES/VIG-MNEL , Rruga - , Ndërtesa Nr. \_\_\_\_\_ , SH/K \_\_\_\_\_ ,  
Apartamenti Nr. \_\_\_\_\_  
Vlera e Pasurisë:  
Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 41 , Dt. 09/12/2000), Rivlerësim \_\_\_\_\_ (Akti Nr. \_\_\_\_\_, Dt. \_\_\_\_\_)

**B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË**

Pronari: BASHKIA VAU - DEJES , Nr. Identifikimi/NIPT K567050070 , Pjesa Takuese 1/1, Lloji i  
Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia SHKODER , Rruga LAÇ (VAU-DEJES) , Ndërtesa Nr. \_\_\_\_\_ , SH/K \_\_\_\_\_ ,  
Apartamenti Nr. \_\_\_\_\_

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Akteve të tjera sipas legjislacionit në fuqi , Nr.  
41 , Datë: 09/12/2000

Regjistruar: Nr. 41 , Datë: 09/12/2000

*\*Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. \_\_\_\_\_ , me Kod Unik \_\_\_\_\_*

**B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK**

Akti Paraparak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: \_\_\_\_\_ , Nr. \_\_\_\_\_ , Datë: \_\_\_\_\_

Përshkrimi i Objektit të Aktit: \_\_\_\_\_

Regjistruar: Nr. \_\_\_\_\_ , Datë: \_\_\_\_\_



REPubLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: \_\_\_\_\_, Emërtimi i Aktit: \_\_\_\_\_, Nr. \_\_\_\_\_, Datë: \_\_\_\_\_

Regjistruar: Nr. \_\_\_\_\_, Datë: \_\_\_\_\_

Përshkrimi:

DREJTORI  
Deart Qori

Erion  
Rrushi

Digitally signed by:  
Erion Rrushi  
Date: 2023.09.13  
11:34:31 +02'00'

Anila  
Hoxha

Digitally signed by:  
Anila Hoxha  
Date: 2023.10.17  
03:38:31 +02'00'

Deart  
Qori

Digitally signed by:  
Deart Qori  
Date: 2023.10.17  
04:00:42 +02'00'



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria  
Vendore Shkodër  
Date: 2023/09/13 11:33:40 +02'00'  
KËË70500702023091311333410ASHK

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADESTRALE

ZONA KADASTRALE: 3769

KODI UNIK


3769003237

NUMRI PASURISË : 738

INDEX I HARTËS:

K-34-76-(57-C)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1:2500

DREJTORI  
(Emer Mbiemer)

SHPJEGUES

□ PARCELA

■ NDERTESA

# PLAN RILEVIMI

## PERGATITI:

HAMID ÇULIQ

Liçensa T. 0675/2 Dt. 10.04.2018

Data e përgatitjes. 15.02.2023

ING. TOPOGRAFI  
HAMID ÇULIQ  
NR. LIÇENSA-102

SIPERFAQE

Sip = 29061.66 m<sup>2</sup>

## IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 3769

NR PASURISE 738-S3 VOL \_\_\_ FAQE \_\_\_

SHKALA 1:2500

INDEKSI I HARTES : K - 34- 76 -(57 -C)

ADRESA E PASURISE

RRETHI: SHKODER FSHATI: VIG

POROSITES: Ecoun Albania Sh.p.k.

